

KOMENTE TË PËRGJITHSHME

Mbi raportin e monitorimit të

KUVENDIT

për tremujorin e tretë të vitit 2014

1. Karakteristikat kryesore të performancës.

Kuvendi, për vitin 2014, administron dhe menaxhon fondet publike sipas dy programeve të miratuara, e konkretisht:

1. Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”
2. Programi “Veprimtaria Ligjvënëse”

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Kuvendi mbi monitorimin e buxhetit për periudhën 9-mujore të vitit 2014, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë institucion, paraqitet si më poshtë vijon.

	Emërtimi	Plani 2014	Fakti 2014	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	1.012.146	612.495	95%	99%	60,5%
1.1	Personeli	600.000	375.492	57%	61%	62,6%
1.2	Operative	412.146	237.003	39%	38%	57,5%
2	Shpenzime kapitale	48.646	8.023	5%	1%	16,5%
2.1	Financim i brendshëm	48.646	8.023	5%	1%	16,5%
2.2	Financim i huaj	0	0	0%	0%	
3	SHUMA	1.060.792	620.518	100%	100%	58,5%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		0	0%	0%	
4	TOTALI	1.060.792	620.518	100%	100%	58,5%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek.

Në tërësi, evidentohet një nivel realizimi prej 58.5 % të planit, në terma vjetore. Shpenzime korente, që përbëjnë rreth 95% të shpenzimeve totale të planifikuara për Kuvendin, ose 99 përqind të shpenzimeve faktike të periudhës, tregojnë një nivel realizmi prej 60.5 për qind. Ndër to, shpenzimet e personelit shfaqin një nivel realizimi prej rreth 63%, dhe përfshijnë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore për 361 punonjës të miratuar me ligjin e buxhetit për Kuvendin. Ky zë shpenzimesh tregon një nivel më të ulët të sesa realizimi i pritshëm prej 75% i periudhës, për disa arsye, që lidhen kryesisht me vakancat në organikën e Kuvendit, dorëzimi i mandatit të Deputetit nga disa Ministra, si dhe penalitetet e parashikuara për mospjesmarrjen në seancat plenare.

Ndërkohë, lidhur me shpenzimet e tjera operative, të cilat gjithashtu shfaqin një nivel realizimi prej rreth 58 për qind, pra relativisht më të ulët se pritshmëria standarte për periudhën 9-mujore. Në fakt, për nga vetë natyra e tyre, shpenzimet operative nuk mund të kenë një shpërndarje të njëtrajtshme gjatë gjithë vitit, apo ndërmjet muajve, pasi një pjesë e madhe e tyre varen nga periudha në të cilën kryhen, nga axhendat politike që do të zbatohen, si dhe nga koha që merr prokurimi i mallrave dhe shërbimeve, të cilat, në disa raste kërkojnë të ripërsëriten. Ndër zërat kryesore, shpenzimet operative përfshijnë shpenzimet financiare për përfitimet ligjore të parashikuara për deputetët, (në rastin e Kuvendit, këto shpenzime përbëjnë rreth 56% të totalit të shpenzimeve operative); shpenzimet për kuotat parlamentare, për udhëtimet jashtë shtetit, shpenzimet për pritje-përcjellje, si dhe shpenzime të tjera kontraktuale në lidhje me shërbimet administrative, sigurimin e materialeve të punës etj.

Shpenzimet kapitale të miratuara për Kuvendin në ligjin vjetor të buxhetit janë rreth 48.6 milion lek, të cilat shfaqin një nivel realizimi për periudhën 9-mujore prej vetëm 16.5 për qind, kryesisht vonesa që lidhen me procesin e prokurimit.

Për periudhën e raportimit 9-mujor, ndarja e shpenzimeve buxhetore ndërmjet programeve, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet në tabelën në vijim.

Emërtimi i Programit	SHPENZIMET KORENTE			SHPENZIMET KAPITALE			Totali i shpenzimeve		% realizimi
	PLAN	FAKT	Realizimi	PLAN	FAKT	Realizimi	Plan	Fakt	
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	363.637	217.554	59,8	48.646	8.023	16,5	412.283	225.578	54,7
Veprimtaria Ligjvënese	648.509	394.940	60,9	0	0		648.509	394.940	60,9
TOTALI	1.012.146	612.495	60,5	48.646	8.023	16,5	1.060.792	620.518	58,5

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek.

Për të dy programet e Kuvendit, përqindja e realizimit të shpenzimeve, varion nga rreth 50% deri në 60%, gjë që ka çuar në një realizim prej 58.5 % në nivel institucioni. Pra, në një vështrim të përgjithshëm, duke gjykuar vetëm mbi realizimin në vlerë të shpenzimeve të planifikuara, për të dy programet e këtij institucioni, evidentohet një performancë e ngadalësuar e cila është mjaft e ndikuar nga niveli i ulët i realizimit të investimeve.

Shpenzimet korente, në dy programet e Kuvendit paraqiten në nivele të pranueshme, duke bërë që në rang institucioni ky nivel të arrijë në 60.5%. Shpenzimet kapitale janë parashikuar vetëm në programin e aparatit të Kuvendit, në vlerë vjetore prej rreth 48.6 milion lek, ndërkohë që janë realizuar vetëm 8 milion lek investime. Në përgjithësi, projektet e investimeve kanë pësuar ndryshime në këtë periudhë të vitit dhe pritjet që pas përfundimit të proceseve të tenderimit të vazhdojnë me realizimin e tyre më të shpejtë në tremujorin e fundit të vitit.

Struktura e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar, buxhetit me ndryshime 2014 dhe realizimit të tremujorit të tretë të vitit 2014, paraqitet si më poshtë.

Kodi	Emërtimi i Programit	Struktura e Buxhetit 2014		
		Plani Fillestar	Plani me ndryshime	Shpenzimet Faktike
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	37.1%	38.9%	36.4%
01120	Veprimtaria Ligjvënëse	62.9%	61.1%	63.6%
	Totali i institucionit	100%	100%	100%

Rreth 36% e totalit të shpenzimeve faktike të vitit 2014, janë përdorur në programin buxhetor “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, ndërsa pjesa tjetër në programin “Veprimtaria Ligjvënëse”. Sikurse evidentohet në tabelën e mësipërme, programi Veprimtaria Ligjvënëse është programi më i madh buxhetor i institucionit të Kuvendit. Përgjithësisht, nuk konstatohen devijime të theksuara ndërmjet shpenzimeve të planifikuara dhe atyre faktike. Diferencat e paraqitura në tabelën e mësipërme vijnë si pasojë e faktit që plani lidhet me periudhën 12-mujore, ndërsa fakti lidhet me periudhën 9-mujore.

MONITORIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

Programi “Planifikimi, menaxhimi, administrimi”.

Kuvendi i Shqipërisë ka planifikuar rreth 412 milion lek për funksionimin e aparatit dhe realizimin e objektivave institucionale. Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson rreth 36.4 përqind të totalit të shpenzimeve faktike 9-mujore. Sipas zërave kryesor krahasuar me zërat e planin vjetor realizimi paraqitet si më poshtë:

01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	363,637	217,554	88%	96.4%	59.8%
1.1	Personeli	253,000	149,853	61%	66.4%	59.2%
1.2	Operative	110,637	67,701	27%	30.0%	61.2%
2	Shpenzime kapitale	48,646	8,023	12%	3.6%	16.5%
2.1	Financim i brendshëm	48,646	8,023	12%	3.6%	16.5%
2.2	Financim i huaj	0	0	0%	0.0%	#DIV/0!
3	SHUMA	412,283	225,578	100%	100.0%	54.7%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0%	0.0%	
4	TOTALI	412,283	225,578	100%	100.0%	54.7%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek.

Sikurse evidentohet, shpenzimet korente përbëjnë 88% të totalit të shpenzimeve të planifikuara dhe 96% të shpenzimeve faktike për periudhën. Në terma vjetore, ato paraqesin një nivel realizimi pre 59.8%. Shpenzimet për paga përbëjnë rreth 61% të planit vjetor dhe 59.8% të shpenzimeve faktike për periudhën 9-mujore. Shpenzimet kapitale, të cilat përbëjnë vetëm 12 % të fondeve të planifikuara për këtë program buxhetor, paraqesin një nivel realizimi mjaft të ulët, ose vetëm 3.6% në terma vjetore. Ndërkohë cngurtësimi i fondeve të shpenzimeve kapitale, dhe rialokimi në projektet e reja sipas prioriteteve të institucionit, së bashku me përfundimin e afateve dhe procedurave të prokurimit, pritët të sjellë një përmirësim të situatës së realizimit të investimeve.

Programi “Veprimtaria Ligjvënëse”.

Ky program përmbledh fondet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për deputetët dhe mirëfunksionimin e parlamentit në përgjithësi, për të cilat janë planifikuar rreth 649 milion lekë. Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson rreth 64 përqind të totalit të shpenzimeve 9-mujore. Sipas zërave kryesore, krahasuar me planin vjetor realizimi paraqitet si më poshtë:

<i>Në mijë lekë</i>						
01120	Veprimtaria Ligjvënëse	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	648,509	394,940	100%	100.0%	60.9%
1.1	Personeli	347,000	225,639	54%	57.1%	65.0%
1.2	Operative	301,509	169,301	46%	42.9%	56.2%
2	Shpenzime kapitale	0	0	0%	0.0%	#DIV/0!
2.1	Financim i brendshëm	0	0	0%	0.0%	#DIV/0!
2.2	Financim i huaj	0	0	0%	0.0%	#DIV/0!
3	SHUMA	648,509	394,940	100%	100.0%	60.9%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0%	0.0%	
4	TOTALI	648,509	394,940	100%	100.0%	60.9%

Burimi: Ministria e Financave.

Sikurse evidentohet nga tabela e mësipërme, shpenzimet korente për paga personelin dhe ato operative rezultojnë me një realizim prej 65 dhe 56 përqind në terma të planit vjetor. Ndërkohë, lidhur me shpenzimet kapitale, duhet theksuar se Kuvendi nuk ka planifikuar investime për vitin 2014, në këtë program buxhetor.

Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit.

Për të dy programet e Kuvendit, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit 2014, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

<i>Në mijë lek</i>			
Programet	Buxheti fillestar 2014	Buxheti me ndryshime	Diferenca
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	386,500	412,283	+25,783
Veprimtaria Ligjvënëse	655,500	648,509	-6,991
Totali i institucionit	1,042,000	1,060,646	+18,646

Burimi: Ministria e Financave

Ndryshimet në planin e buxhetit, shpjegohen me ndryshimet në fondet e Kuvendit, në zbatim të VKM-së për transferimin e fondeve prej 25 milion lek nga programi “Veprimtaria Ligjvënëse”, në programin “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, si dhe përdorimin e fondit të vecantë, sipas miratimeve rast pas rasti nga Ministri i Financave, konform legjislacionit në fuqi dhe në vijim të kërkesave të Kuvendit, celjes së fondeve për shlyerjen e

detyrimeve të prapambetura si dhe zbatimin e Aktit Normativ të muajit shtator 2014, për ndryshimin e buxhetit të vitit 2014.

Krahasimi i shpenzimeve faktike

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Kuvendi	MF	Dif	Kuvendi	MF	Dif.	Kuvendi	MF	Dif
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	217,554	217,554	0	8,023	8,023	0	225,578	225,578	0
Veprimtaria Ligjvënese	394,940	394,940	0		0	0	394,940	394,940	0
Totali i Shpenzimeve	612,494	612,495	0	8,023		0	620,518	620,518	0

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse evidentohet edhe më sipër, nuk vërehen diferenca midis shpenzimeve faktike të raportuara nga Kuvendi dhe të dhënave sipas sistemit informatik financiar të qeverisë.

Komente të tjera

- Në raportin e monitorimit, duhet të përfshihet informacion mbi realizimin e të gjitha produkteve të programeve buxhetore, të cilat gjithashtu duhet të jenë të lidhura edhe me realizimin e objektivave të politikës së programit.

Publikimi në faqen e internetit

Kuvendi nuk ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportin e monitorimit vjetor të buxhetit për tremujorin e tretë të vitit 2014.